



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME

Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën komunale
Në Zonën Kadastrale - Davidovc
Nr.01-060/01-11563/21 datë:26.05.2021



Npi – 01/136 datë: 27.05.2021

Bazuar në Nenin (4), (5), (6.1.2), (8.1.2), (15), (17), dhe (19) të Ligjit Nr. 06/L-092, Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës; Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën komunale në Zonën Kadastrale Davidovc, Npi – 01/275 datë: 24.11.2020; Si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për Zgjedhjen e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme Komunale në Zonën Kadastrale Davidovc Npi – 01/314 datë: 22.12.2020. Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën Komunale në Zonën Kadastrale - Davidovc, ka shqyrtuar Njoftimin Publik Npi-01/114 të datës: 23.04.2021, si dhe Rekomandimin e Komisionit për shqyrtimin e Ankesave Npi-01/134 të datës 26.05.2021 dhe aprovoi këtë:

R E K O M A N D I M
PËR KUVENDIN E KOMUNËS - SHTIME

I

Komisioni Vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën Komunale në Zonën Kadastrale – Davidovc, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.05.2021, unanimisht ka vendosur ti Rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të aprovojë Vendimin për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, Ngastrën Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4 me gjithësej sipërfaqe 21986 m², në Zonën Kadastrale- Davidovc; Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal-Shtime, këtyre Ofertuesve si vijon:

1. Pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej, 6700m² (gjashtëdhjetë e shtatë ari) i epen firmës AUTOCENTER “A-Grup” SH.P.K. Nr. i biznesit: 811565540 Adresa: Rr. “Ibrahim Rugova” Davidovc, me përfaqësues Albtor Shehu.
 - Numri i punëtorëve: 27 brenda dy viteve,
 - Shuma e Investimeve: 1.043.095,00 euro brenda dy viteve,
 - Pagesa vjetore e qirasë: 10 (dhjetë) euro për ari,
 - Veprimtaria: Prodhuese (Plastikë e aksesori të automjeteve),
 - Numri i Poenave: 429 ose 85.8%.
2. Pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej, 6900m² (gjashtëdhjetë e nëntë ari) i epen firmës “Loni Pergola” SH.P.K. Nr. i biznesit: 811023738, Adresa; Rr.”Ibrahim Rugova” Nr.962 Shtime, me përfaqësues Sadik Tërshana.
 - Numri i punëtorëve: 30 brenda dy viteve,
 - Shuma e Investimeve: 478.000 euro brenda dy viteve,
 - Pagesa vjetore e qirasë: 15 (pesëmbëdhjetë) euro për ari,
 - Veprimtaria: Prodhuese,
 - Numri i Poenave: 419 ose 83.8 %.

3. Pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej, 2928,66 m² (njëzet e nëntë ari e njëzet e tetë metra) i epen firmës N.T.P. “Gajrepi” Nr. i biznesit: 810621096, Adresa: Rr. “12 Qershori” Shtime, me përfaqësues Selman Sokoli.
- Numri i punëtorëve: 30 brenda dy viteve,
 - Shuma e Investimeve: 478.000 euro brenda dy viteve,
 - Pagesa vjetore e qirasë: 15 (pesëmbëdhjetë) euro për ari,
 - Veprimtaria: Prodhuese,
 - Numri i poenave: 403 ose 80.6 %.
4. Pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej, 2728,66 m² (njëzet e shtatë ari e njëzet e tetë metra) i epen firmës B.I./D.P.Z ‘Fidani Plast’ Nr. i biznesit: 810622044, Adresa: Rr. “Adem Jashari” Shtime, me përfaqësues Xhelal Gashi.
- Numri i punëtorëve: 23 brenda dy viteve,
 - Shuma e Investimeve: 405.000 euro brenda dy viteve,
 - Pagesa vjetore e qirasë: 20 (njëzet) euro për ari,
 - Veprimtaria: Prodhuese, (plastikë)
 - Numri i Poenave: 384 ose 76.8 %.
5. Pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-4, me sipërfaqe prej 2728,66 m² (njëzet e shtatë ari e njëzet e tetë metra) i epen firmës, D.P.Z. “Dizajni” Nr. i biznesit: 81024075, Adresa: Rr. “Ahmat Kaçiku” p.n. Shtime, me përfaqësues Dardan Hysaj.
- Numri i punëtorëve: 21 brenda dy viteve,
 - Shuma e Investimeve: 403.000 euro brenda dy viteve,
 - Pagesa vjetore e qirasë: 25 (njëzet e pesë) euro për ari,
 - Veprimtaria: Prodhuese, (me dru)
 - Numri i Poenave: 361 ose 72.2 %.

II

Rekomandimi u dërgohet: Arkivit, Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Kryesuesit të Komisionit Vlerësues.



Kryesuesi i Komisionit
Herolind Selmani